



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Administratës



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201600583/7

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2016

**Lënda :** *Rekomandim për një ndryshim në listën e pronarëve bashkëngjitur VKM Nr.343, datë 22.04.2015 "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i linjës së trasmetimit 110 KV, Uznovë–Çorovodë".*

**Drejtuar :** **Ministria e Energjisë dhe Industrisë**  
Sekretarit të Përgjithshëm  
Z. Koli Bele

TIRANË

**Operatori i Sistemit të Trasmetimit**  
Administrator i OST sh.a  
Z. Engjëll Zeqo

TIRANË

**Për dijeni:** **ZVRPP Skrapar**  
Rregjistruetit

SKRAPAR

*Të nderuar zotërinj,*

Shtetasi F.S.D, ka paraqitur një ankesë pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, në të cilën ngrihet shqetësimi ndaj ZVRPP Skrapar në lidhje me refuzimin e aplikimit të kryer në muajin Janar 2016, për rregjistrimin e Dëshmisë të Trashëgimisë Ligjore me nr.61 rep., nr.50 kol., datë 21.01.2015 dhe lëshimin e çertifikatës të pronësisë për pasurinë me nr.32/16, ZK 3019, vendodhje Poliçan, Skrapar, për shkak se, një pjesë e sipërfaqes të kësaj prone prej 45 m<sup>2</sup> është në listen e pronave të shpronësuar për interes publik në favor të OST sh.a (Operatorit i Sistemit të Trasmetimit), për ndërtimin e linjës të trasmetimit 110 KV Uznovë–Çorovodë, në bazë të **VKM nr.343, datë 22.04.2015 "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i linjës të trasmetimit 110 KV Uznovë – Çorovodë"** (lista bashkëngjitur këtij vendimi).

Institucioni i Avokatit të Popullit në zbatim të procedurave të tij ligjore për shqyrtimin e rastit, të parashikuara në Ligjin nr.8454, datë 04.02.1999 "Për

Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, neni 18/b ku thuhet shprehimisht se: *“Pas pranimit të ankesës, kërkesës apo njoftimit për shqyrtim, Avokati i Popullit kryen një të veprimet e mëposhtme:...b) kërkon shpjegime nga organet e administratës...”*, është drejtuar me shkresë nr.K3/F12-2, datë 12.04.2016 ZVRPP Skrapar dhe shkresë nr. K3/F12-4, datë 12.04.2016 OST sh.a, për të dhënë shpjegimet e tyre lidhur me objektin e ankesës të paraqitur nga z. F.D.

Në përgjigje të shkresës tonë, ZVRPP Skrapar me shkresë nr.1435/1 prot., datë 15.04.2016 bën me dije se: *“...Sa i përket veprimeve lidhur me pasurinë nr.32/16, ZK 3019 me vendodhje Poliçan, Skrapar, me VKM nr.343, datë 22.04.2015 “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i linjës të trasmetimit 110 KV Uznovë – Çorovodë”, pika 7 është vendosur pezullimi i të gjitha transaksioneve mbi këto pasuri deri në përfundim të procesit të kalimit të pronësisë së pasurive të shpronësuar në favor të OST sh.a dhe se pasuria e mësipërme është bashkëlidhur VKM-së nr.343...”*

Nga ana e shoqërisë OST sh.a në përgjigje tonës, me shkresë nr.2244/1 prot., datë 26.04.2016 na informon se: *“...nga verifikimi paraprak i dokumentacionit të ardhur nga pronari z. F.D, pronësia e tij nuk preket nga ndërtimi i linjës 110 KV Uznovë – Çorovodë...”*. Po ashtu, OST sh.a me kërkesë të subjektit ankues ka kryer dhe verifikimin në terren me specialistët e saj për sipërfaqen e pronës që pretendohet që preket nga ky investim publik dhe me shkresë nr.598/1, datë 22.02.2016 theksohet se, *“...nga verifikimi në terren në dt.18.02.2016, pasuria juaj me nr.32/16, ZK 3019, nuk preket nga ndërtimi i linjës 110 KV Uznovë – Çorovodë...”* (bashkëlidhur dhe Planrilevimi).

Gjatë procesit të hetimit të ndërmarrë nga Institucioni Avokatit të Popullit, ekspertë të Institucionit kanë kontaktuar në vend me përfaqësues të shoqërisë OST sh.a dhe nga kqyrja e dokumentacionit që disponohet rreth trajtimit të kësaj ankese rezulton se, pasuria me nr.32/16, ZK 3019, nuk preket nga ndërtimi i linjës 110 KV Uznovë – Çorovodë, pasi përfshirja e saj në listen e pronave që shpronësohen është hedhur në mënyrë të gabuar.

Në përfundim të hetimit administrative të kryer nga ana jonë rezulton se, për realizimin e të drejtës ligjore të shtetasit F.D për gëzimin e të drejtës të pronës duke disponuar lirisht atë, dhe lejjimin e vijimit të procedurave për regjistrimin e Dëshmisë të Trashëgimisë Ligjore me nr.61 rep., nr.50 kol., datë 21.01.2015 dhe lëshimin e çertifikatës të pronësisë për pasurinë me nr.32/16, ZK 3019, vendodhje Poliçan, Skrapar, nga ana e ZVRPP Skrapar, duhet të bëhen ndryshime në listën e pronarëve (bashkëlidhur VKM nr.343, datë 22.04.2015) që shpronësohen për efekt të ndërtimit të linjës 110 KV Uznovë – Çorovodë, për heqjen e kësaj pasurie nga kjo listë dhe lejjimin e kryerjes të veprimeve hipotekore sipas parashikimeve në Ligjin nr.33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës, ku thuhet shprehimisht se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”, dhe në vijim të nenit 24/b, të Ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, me ndryshimet e mëvonshme ku thuhet shprehimisht se: “Kur Avokati i Popullit vëren se është vetë përmbajtja e ligjit ose e akteve të tjera normative dhe jo zbatimi i tyre shkaku që krijon premisa për shkelje të të drejtave të njeriut, të njohura nga Kushtetuta ose nga ligjet e tjera, ka të drejtë:

b) t’u propozojë organeve të administratës ndryshimin ose përmirësimin e akteve nënligjore...”

## **R E K O M A N D O J M Ë:**

Në përputhje me pikën 1, të nenit 81, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, realizimin e iniciativës legjislative, për një ndryshim në listën e pronarëve që shpronësohen për efekt të ndërtimit të linjës 110 KV Uznovë – Çorovodë, në zbatim të VKM nr.343, datë 22.04.2015, me qëllim heqjen nga lista e pasurisë me nr.32/16, ZK 3019, vendodhje Poliçan, Skrapar, për sipërfaqen 47 m<sup>2</sup>, me qëllim vijimin e procedurave nga ZVRPP Skrapar për rregjistrimin e Dëshmisë të Trashëgimisë Ligjore me nr.61 rep., nr.50 kol., datë 21.01.2015 dhe lëshimin e çertifikatës të pronësisë në emër të subjektit F.D dhe trashëgimtarëve të tjerë ligjor, sipas parashikimeve në Ligjin nr.33/2012 “Për rregjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

Bashkëngjitur këtij rekomandimi po ju dërgojmë:

1. Kopje të përgjigjes të ZVRPP Skrapar me shkresës nr.1435/1 prot., datë 15.04.2016.
2. Kopje të përgjigjes të OST sh.a me shkresë nr.2244/1 prot., datë 26.04.2016.
3. Kopje të shkresës të OST me nr.598/1, datë 22.02.2016 drejtuar subjektit ankues F.D.

Për masat e marra për zbatimin e rekomandimit, lutemi të na vini në dijeni, brënda afatit 30 ditor që përcakton Ligji nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

*Duke besuar në bashkëpunimin tuaj,*

**KOMISIONERE**

**Etilda GJONAJ(SALIU)**